REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2022:107970
Datë:	01.09.2022
Numri i dokumentit:	03380500

AA.nr.565/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses - propozueses N.Sh nga Gjilani të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.Inga Gjilani, kundër të paditurës-kundër propozueses Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Inspeksionit në Gjilan, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit-propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1305/2022, të datës 22.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses-propozueses N.S nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative A.nr.1305/22, i datës 22.06.2022, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar A.nr.1305/22, të datës 22.06.2022, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e paditëses - propozueses N.SH nga Gjilani, me të cilin ka kërkuar që te shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurës-kundër propozuesit, Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Inspeksionit deri në përfundim të procedurës gjyqësore sipas padisë së ushtruar në Gjykatë, lidhur me këtë çështje, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të: shkeljes të dispozitave ligjore të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1305/22 i datës 22.06.2022, të ndryshohet, apo lënda të kthehet në rivendosje.

2022:155331

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e paditësit-propozuesit të masës të sigurimit është **e pa-bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi- propozuesi i sigurimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datën 27.05.2022, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit nr.prot 14-02.303/44226 të datës 12.05.2022 Komuna e Gjilanit- Drejtoria e Inspeksionit në Gjilan si të paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit me aktvendimin A.nr.1305/22, të datës 22.06.2022, e ka refuzuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Në arsyetim të aktvendimit është konstatuar se paditësi propozuesi i sigurimit nuk ka dhënë fakte për të mbështetur kërkesën e saj, respektivisht nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e kushteve të parapara me nenin 22 par.2 të LKA-së. Kërkesa tërësisht është mbështetur në provat dhe faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas shqyrtimit të kërkesëpadisë, por të cilat nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK në lidhje me nenin 63 të LKA -së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 63 të LKA -së, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA -së, përcaktohet në mënyrë të qartë se "*masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se provohet besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive civile apo dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës.* Në nenin 22 par. 2 të LKA -së është përcaktuar se*: "me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar",* ndërsa në par. 6 të po këtij neni përcaktohet se *"paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në par. 2 të këtij neni".*

2022:155331

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak se gjykata e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e masës së sigurimit -shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nga ku ka rezultuar se paditësi -propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtën e tij subjektive civile, e po ashtu nuk është argumentuar fakti se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës së paditësit - propozuesit për realizimin e kërkesëpadisë.

Megjithatë në rrethanat aktuale të rastit, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë sikurse ka vendosur gjykata e shkallës së parë, të cilën mënyrë të vendosjes e përkrah edhe kjo gjykatë. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e **tërë kësaj procedure** e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 209 par. 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.565/22, datë 29.08.2022

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari,
Mehmet Ndrecaj

2022:155331